



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
KRYETARI**

Adresa: Blv "Dëshmorët e Kombit", nr.3, Tiranë;

E-mail: [klsh.org.al](mailto:klsh.org.al); ëeb-site: [ëëë.klsh.org.al](http://ëëë.klsh.org.al)

Nr.1077/8Prot.

Tiranë, më 19.03.2018

**V E N D I M**

**Nr. 16, Datë 19.03.2018**

**PËR**

**AUDITIMIN E USHTRUAR NË ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, MALËSI E MADHE "PËR ZBATIMIN E PROCEDURËS LIGJORE NË PRANIMIN DHE ADMINISTRIMIN E DOKUMENTACIONIT TEKNIKO-LIGJOR PËR REGJISTRIMIN FILLESTAR TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, EVIDENTIMIN DHE TRAJTIMIN LIGJOR TË MBIVENDOSJEVE", për periudhën nga data 01.01.2015 deri më datën 30.09.2017**

Nga auditimi i ushtruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Malësi e Madhe, rezultoi që veprimtaria e subjektit të audituar, në drejtim çështjeve që lidhen me vlerësimin e procedurave të shqyrtimit dhe miratimit të kërkesave për regjistrim AMTP dhe legalizime, nuk ka qenë plotësisht efektive, veçanërisht në vlerësimin e përmbajtjes së dokumentacionit paraqitur për kryerje transaksionesh, rivlerësime, etj.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve të Auditimit dhe Etikës, si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr.154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",

**VENDOSA**

**I.** Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit "Për zbatimin e procedurës ligjore në pranimin dhe administrimin e dokumentacionit tekniko ligjor për regjistrimin fillestar të pasurive të paluajtshme, evidentimin dhe trajtimin ligjor të mbivendosjeve", të ushtruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Malësi e Madhe, për periudhën 01.01.2015 deri më 30.09.2017.

**II.** Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

## **A. MASA ORGANIZATIVE:**

**1-Gjetje:** ZVRPP Malësi e Madhe në **12 raste** që i përkasin ZK 2220, Qyteti Koplík, ka regjistruar pasuritë e paluajtshme për poseduesit e AMTP-ve përkatëse, me referencat: nr. 2957, nr. 3005, nr. 2991, nr. 2866, nr. 2868, nr. 2897, nr. 2934, 2970, nr. 2952, nr. 2954, nr. 2977, nr. 2928, *duke mos zbatuar kërkesat ligjore, pasi* regjistrimi i pasurive është kryer duke tjetërsuar pasuritë trual+ndërtesë, të regjistruara në pronësi “shtet, duke kaluar truallin me sipërfaqe totale **1362 m<sup>2</sup>** në pronësi të qytetarëve posedues të AMTP-ve, ndërsa në **7 raste** nga këto, pasuritë ndërtesë me sipërfaqe totale **932 m<sup>2</sup>**, janë hequr nga KPP, duke fshirë të drejtën reale mbi këto pasuri, sa vepruar në **papajtueshmëri** me shkronjën “a” neni 25 dhe pikën 3 neni 34, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

**Rekomandim 1.1:** Regjistruesi i ZVRPP Malësi e Madhe të marrë masa, në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, **bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi** për pasuritë në **12 raste**, të veçojë e regjistrojë “shtet” sipërfaqet e perfituara padrejtësisht, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor, sipas pasqyrës nr. 1 (bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit).

**2-Gjetje:** ZVRPP Malësi e Madhe në **5 raste** që i përkasin ZK 2220, qyteti Koplík, ka regjistruar pasuritë e paluajtshme sipas AMTP-ve: nr. 733 në emër të S.A; nr. 746 në emër të R.A ; nr. 827 në emër të A.C nr. 489 në emër të M.SH; nr. 832 në emër të A.M.At, të cilat **rezultojnë të korigjuara, duke shtuar parcela për rrejdhojë sipërfaqja takuese, është rritur fiktivisht duke përfiturar** më tepër **25100 m<sup>2</sup>**, në favor të poseduesëve të AMTP-ve, se sipërfaqja takuese sipas AMTP-së përkatëse, sa vepruar në **papajtueshmëri** me shkronjën “a” neni 25 dhe pikën 2 neni 45, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

**Rekomandim 2.1:** Regjistruesi i ZVRPP Malësi e Madhe të marrë masa, në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, **bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi** për pasuritë në **5 raste**, të veçojë e regjistrojë “shtet” sipërfaqet e perfituara padrejtësisht, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor, sipas pasqyrës nr. 1 (bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit).

**3-Gjetje:** ZVRPP Malësi e Madhe në **12 raste** që i përkasin ZK 2220, qyteti Koplík, ka regjistruar pasuritë e paluajtshme sipas AMTP-ve, me referenca përkatëse: nr. 2952, nr. 2954, nr. 2815, nr. 2866, nr. 2868, nr. 2957, nr. 1429, nr. 1435, nr. 1459, nr. 2928, nr. 2027, 1624 *duke mos zbatuar kërkesat ligjore, pasi janë regjistruar si tokë bujqësore edhe* trualli që përmban AMTP-ja përkatëse, për rrjedhojë është regjistruar në favor të poseduesëve të AMTP-ve, më tepër një sipërfaqe toke në total prej **2310 m<sup>2</sup>**, si dhe në **2 raste** sipas AMTP-ve nr. 196 dhe nr. 736, është regjistruar në favor të poseduesëve të AMTP-ve, më tepër një sipërfaqe toke në total prej **14600 m<sup>2</sup>**, se sipërfaqja takuese, sa vepruar në **papajtueshmëri** me shkronjën “a” neni 25 dhe pikën 2 neni 45, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

**Rekomandim:** Regjistruesi i ZVRPP Malësi e Madhe të marrë masa, në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, **bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi** për pasuritë në **14 raste**, të veçojë e regjistrojë “shtet” sipërfaqet e perfituara padrejtësisht, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor dhe zbatimin e procedurave kërkesave ligjore, pasuri të pasqyruara në tabelën nr. (bashkëlidhur Projektraportit të auditimit).

**-Gjetje:** ZVRPP Malësi e Madhe në **11 raste**, ka regjistruar pasuri të paluajtshme, me referenca: nr. 2055, nr. 2997, nr. 1693, nr. 0831, nr. 23878/1, nr. 2950, nr. 0673, 2042, nr. 1368, nr. 2038, nr. 2862, *duke mos zbatuar kërkesat ligjore, pasi* për një trung familjar janë lëshuar 2 e më shumë

AMTP, duke shkelur kriterin e ndarjes së tokës sipas normës për frymë të çdo fshati, për rrejdhojë nga regjistrimi i tyre **kanë përfituar më tepër në total tokë me sipërfaqe 274500 m<sup>2</sup>**, se sipërfaqja takuese e ndarë sipas normës për frymë, bazuar në përbërjen familjare me 1.08.199, sa vepruar **në papajtueshmëri** me pikën 2 neni 3, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për Shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore” dhe në pikën 2, të VKM-së nr. 255 “Për Kriteret e ndarjes së tokës”, e ndryshuar, përsa i përket regjistrimit të pasurive tokë bujqësore të ndara me ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për Tokën”, i ndryshuar.

**Rekomandim 4.1:** Regjistruesi i ZVRPP Malësi e Madhe të marrë masa, në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, **bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi** për pasuritë, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor dhe në zbatimin e procedurave sipasi VKM nr. 994, datë 9.12.2015, si dhe të dërgojë AMTP-të përkatëse, për vlerësim në KVVTP pranë Prefektit të Qarkut Shkodër, sipas pasqyrës nr. 1 (bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit).

**5-Gjetje:** ZVRPP Malësi e Madhe në **4 raste**, ka regjistruar pasuri të paluajtshme, sipas referncave: nr. 1945, nr. 3024, nr. 1545, nr. 0517, duke lëshuar certifikata pronësie për pasuri truall+ndërtesë, me sipërfaqe totale trualli prej **800 m<sup>2</sup>** dhe ndërtesa me sipërfaqe totale prej **466 m<sup>2</sup>**, rezulton se regjistrimi i tyre **është bërë pa asnjë dokumentacion ligjor që shërben si Titull Pronësie**, veprim në papajtueshmëri me shkronjën a neni 25, pikën 2 neni 45, të ligjit nr. 33/2012, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

**Rekomandim 5.1:** Regjistruesi i ZVRPP Malësi e Madhe të marrë masa, në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, **bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi** për pasuritë: nr. 52, vol. 1, faqe 52, ZK 1244; nr. 451, vol. 3, faqe 30; nr. 392, vol. 5, faqe 209; nr. 423/1, vol. 5, faqe 244; dhe pasuria nr. , vol. 18, në emër të Islam Semanaj(keto janë ZK 2220), deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor (të pasqyruara në tabelën nr. 1, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit).

**6-Gjetje:** ZVRPP Malësi e Madhe në **3 raste**, ka regjistruar pasuri të paluajtshme sipas AMTP-ve, të cilat **janë lëshuar për persona që nuk janë përfitues të tokës**, pasi nuk janë brenda juridiksionit që ushtron detyrën Komisioni i Ndarjes së Tokës në Fshat, kjo e vërtetuar me certifikatën e përbërjes familjare datë 1.08.1991, veprim në papajtueshmëri me pikën 2 neni 3, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për Shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar, neni 25/a, të ligjit nr. 33/2012, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe pikën 2, të VKM-së nr. 255 “Për Kriteret e ndarjes së tokës”, e ndryshuar, përsa i përket regjistrimit të pasurive tokë bujqësore të ndara me ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për Tokën”, i ndryshuar .

**Rekomandim 6.1:** Regjistruesi i ZVRPP Malësi e Madhe të marrë masa, në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, **bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi** për pasuritë e rëgjiastruara sipas AMTP-ve: nr. 920; nr. 814 dhe nr. 728, ZK 2220, deri në konfirmimin zyrtar nga pushteti vendor, që përfituesit e këtyre AMTP-ve, nuk janë trajtuar me tokë në fshatrat që rezultonin banorë deri më 01.08.1991(pasqyruara në tabelën nr. 1 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit).

**7-Gjetje:** ZVRPP Malësi e Madhe në **3 raste**, ka regjistruar pasuri të paluajtshme sipas AMTP-ve nr. 912 dhe nr. 73, nr. 489, të cilat janë të parregullta dhe nuk mund të shërbejnë si **Titull Pronësie, pasi ju mungojnë elementët e formës dhe përmbajtjes**, nuk kanë të përcaktuar zërin kadastral të tokës bujqësore, veprim në papajtueshmëri me gemën “a” neni 25, të ligjit nr. 33/2012, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, pikën 5, të VKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruarit” dhe germën “d”

pika 1, të UKM nr. 994, datë 9.12.2015 "Për Procedurën e Regjistrimit të Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi(AMTP)".

**Rekomandim 7.1:** Regjistruesi i ZVRPP Malësi e Madhe të marrë masa, në bazë të pikës "1" neni 5, pikës "1" neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme", **bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi** për pasuritë e regjistruara sipas AMTP-ve nr. 912 dhe nr. 73, nr. 489, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor dhe në zbatimin e procedurave sipasi VKM nr. 994, datë 9.12.2015, sipas pasqyrës nr. 1(bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit).

**8-Gjetje:** ZVRPP Malësi e Madhe në **8 raste**, ka regjistruar pasuri të paluajtshme sipas AMTP-ve, **në mungesë të dokumentacionit teknik ligjor**, pasi në 4 raste nuk është krijuar dosje me dokumentacionin e kërkuar, që merr një numër reference, por në arkivën e ZVRPP gjendet vetëm AMTP-ja, ndërsa në të gjitha rastet mungon certifikata e përbërjes së trungut familjar me datë 01.08.1991, veprim në papajtueshmëri me germën "d" pika 1, të UKM nr. 994, datë 9.12.2015 "Për Procedurën e Regjistrimit të Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi(AMTP)" dhe Rregulloren nr. 184, datë 08.04.1999 "Për Punën e ZRPP", e ndryshuar.

**Rekomandim 8.1:** Regjistruesi i ZVRPP Malësi e Madhe të marrë masa, në bazë të pikës "1" neni 5, pikës "1" neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme", **bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi** për pasuritë e rëgjiastruara sipas AMTP-ve, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor dhe në zbatimin e procedurave sipasi VKM nr. 994, datë 9.12.2015, sipas pasqyrës nr. 1(bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit).

**9-Gjetje:** ZVRPP Malësi e Madhe në **shumë raste**, ka regjistruar tokë bujqësore, por zëri kadastral që përmban AMTP-ja përkatëse, është i ndryshëm me zërin kadastral që pasqyrohet në KPP, ndërsa ZVRPP Malësi e Madhe, nuk duhet të procedonte me regjistrimin e pasurive përkatëse, por duhet ti drejtohej DAMT Qarku Shkodër, për të konfirmuar zërin kadastral, veprim në papajtueshmëri me germën "b" pika 5, të UKM nr. 994, datë 9.12.2015 "Për Procedurën e Regjistrimit të Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi(AMTP)".

**Rekomandim 9.1:** Regjistruesi i ZVRPP Malësi e Madhe të marrë masa, që për çdo rast të mos përputhjes së zërit kadastral të parcelës që përmban AMTP-ja, me atë të pasqyruar në KPP, të kërkojë konfirmimin nga DAMT Qarku Shkodër, duke proceduar për regjistrimin i pasurisë bazuar në konfirmimin e zërit kadastral të DAMT-së.

**10- Gjetje:** ZVRPP Malësi e Madhe në 4 **raste** ka regjistruar *pasuri në favor* të poseduesëve të AMTP-ve: nr. 59 në emër të B.V zk 1376, nr. 13 në emër të L.L.P, nr. 20 në emër të P.C dhe nr. 4 në emër të M.D.P , por në këto raste AMTP-të **nuk shërbejnë si Titull Pronësie**, pasi pasuritë e regjistruara nuk janë të llojit "**tokë bujqësore**", për rrjedhojë në kundërshtim me dispozitat ligjore është tjetërsuar pasuria "shtet" me sipërfaqe totale **9696 m<sup>2</sup>**, që në KPP dhe regjistrat përkatës figuron e **llojit: "shesh", "truall" dhe "kullotë"**, ndërsa nga punonjësit e ZVRPP Malësi e Madhe, në të gjitha rastet janë lëshuar certifikata pronësie **për tokë arë**, veprim **në papajtueshmëri** me shkronjën "a" neni 25, nenin 45, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", nenin 2, të ligjit nr. 9948, datë 7.07.2008 "Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë ligjore të krijimit të Titujve të Pronësisë mbi tokën bujqësore ", nenin 3, të ligjit nr. 8337, datë 30.04.1998 "Për Kalimin në pronësi të tokës bujqësore, pyjore, livadheve dhe kullotave" dhe nenin 3, të ligjit nr. 7501, datë 17.09.1991 "Për tokën", të ndryshuar .

**Rekomandim 10.1:** Regjistruesi i ZVRPP Malësi e Madhe të marrë masa, në bazë të pikës "1" neni 5, pikës "1" neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme", **bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë deri në deri në kofirmimin nga DAMT Qarku Shkodër**, lidhur me zërin kadastral të këtyre pasurive, sipas pasqyrës(bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit).

**11-Gjetje:** ZVRPP Malësi e Madhe në **2 raste**, ka regjistruar pasuri të paluajtshme sipas lejeve të legalizimit, duke lëshuar certifikata pronësie për pasuri truall+ndërtesë, me sipërfaqe totale truall prej **405 m<sup>2</sup>** dhe ndërtesa me sipërfaqe totale prej **234 m<sup>2</sup>**, rezulton se regjistrimi i tyre **është bërë**

*në mungesë të dokumentit që shërben si Tirull pronësie, pasi AMTP-ja e përcaktuar si Titull Pronësie, nuk mund të shërbejë si e tillë.* veprim në papajtueshmëri me nenin 193 të ligjit nr.7850 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, datë 29.7.1994, i ndryshuar, me germën “a” neni 25, pika 2 neni 45, të ligjit nr. 33/2012, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

**Rekomandim 11.1:** Regjistruesi i ZVRPP Malësi e Madhe të marrë masa, në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, **bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi** për pasuritë: nr. 389/9, vol. 18, faqe 138, ZK 2220; nr. 398/12, vol. 18, faqe 141; ZK 2220, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

**12-Gjetje:** ZVRPP Malësi e Madhe në **3 raste**, ka regjistruar pasuri të paluajtshme sipas lejeve të legalizimit, duke lëshuar certifikata pronësie, duke tjetërsuar pasurinë shtet truall me sipërfaqe totale **1030 m<sup>2</sup>**, duke kaluar në pronësi të poseduesëve të lejeve të legalizimit, *në mungesë të dokumentit që shërben si Tirull pronësie, pasi AMTP-ja e përcaktuar si Titull Pronësie, nuk mund të shërbejë si e tillë,* veprim në papajtueshmëri me nenin 193 të ligjit nr.7850 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, datë 29.7.1994, i ndryshuar, me germën “a” neni 25, pika 2 neni 45, të ligjit nr. 33/2012, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

**Rekomandim 12.1:** Regjistruesi i ZVRPP Malësi e Madhe të marrë masa, në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, **bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi** për pasuritë: nr. 9/56, vol. 16, faqe 27, ZK 2220; nr. 7/175, vol. 10, faqe 27 dhe nr. 7/228, vol. 10, faqe 233; ZK 2220, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

**13-Gjetje:** ZVRPP Malësi e Madhe në **9 raste** të konstatuara, ka regjistruar Leje legalizimi, ndërsa *në genplanin e hartuar nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Shkodër, nuk janë përcaktuar shenja lidhëse të parcelës ndërtimore me objektin, gjithashtu në genplan nuk përcaktohet rruga hyrëse dhe dalja nga parcela ndërtimore,* nga hartografi nuk është përgatitur kopje e hartës tregues të regjistrimit (HTR) ku të përcaktoj me vijëzim me ngjyre te kuqe pozicionin gjeografik të pasurisë, veprim *në papajtueshmëri* me pikën 10.6, Kreu i II, të Regullorës nr. 184, datë 08.04.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar .

**Rekomandim 13.1:** Regjistruesi i ZVRPP Malësi e Madhe në bashkëpunim me *Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Shkodër* të marrë masa, që *në genplanet e lejeve të legalizimit, të jetë e përcaktuar shenja lidhëse e parcelës ndërtimore me objektin, si dhe të përcaktohet rruga hyrëse dhe dalja nga parcela ndërtimore,* në të kundërt ZVRPP Malësi e Madhe, të mos procedojë me vazhdimin e regjistrimit të lejes së legalizimit përkatëse.

**14-Gjetje:** ZVRPP Malësi e Madhe në **1 rast**, ka regjistruar pasuri të paluajtshme sipas lejes të ndërtimit, për pasuri truall+ndërtesë, rezulton se regjistrimi i tyre *është kryer me parregullsi dhe pasaktësi të dokumentacionit urbanistik,* veprim në papajtueshmëri me pikën 2 neni 45, të ligjit nr. 33/2012, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruarit” .

**Rekomandim 14.1:** Regjistruesi i ZVRPP Malësi e Madhe të marrë masa dhe në bashkëpunim me organet e pushtetit vendor, të kërkojë saktësimin dhe konfirmimin e dokumentacionit ligjor që ka shërbyer për regjistrimin e pasurisë nr. 188/1, vol. 12, faqe 30.

**15-Gjetje:** ZVRPP Malësi e Madhe në **3 raste**, nuk ka ndjekur procedurat lidhur me zbatimin e vendimeve që kanë marrë formë të prerë, marrë nga Gjykata e Shkallës Pare Administrative Shkodër dhe Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë (KVVTP) Prefekti Qarkut Shkodër, ndërsa gjykata ka vendosur pavlefshmëri për të paditurit nga KVVTP, mbajtës të AMTP-ve sipas vendimeve, të cilat i janë dërguar ZVRPP-së për regjistrim të pavlefshmërisë së plotë dhe të pjesshme, duke *urdhëruar kthimin me pronarë shtet për disa pasuri,* ku rezulton se:

- Nuk është vendosur kufizim për këto pasuri, gjatë fillimit dhe zbatimit të procedurave të shqyrtimit të verifikimit.

-Nuk janë marrë masat përkatëse, për të siguruar dhe regjistruar “Shtet”, pasuritë e përcaktuara në vendimin e gjykatës, pas përfundimit të procesit të shqyrtimit, si pasojë lënien në gjendje juridike me pronësi të mbajtësit të paligjshëm.

Veprime këto ne kundërshtim me nenin 59 dhe nenin 74, të ligjit nr. 33/2012, datë 21.3.2012 “Për regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, me vetë Vendimet e Gjykatave, dhe në kundërshtim me Ligjin nr. 9948, datë 7.07.2008 “Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore” të ndryshuar .

**Rekomandim 15.1:** Regjistruesi i ZVRPP Malësi e Madhe të marrë masa, që në vazhdimësi të vendosë kufizim për pasuritë me origjinë nga AMTP, për të cilat ka filluar procedura e shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore, si dhe të veçojë e regjistrojë “shtet” sipërfaqet e tokës, për të cilat janë shprehur vendimet e gjykatës dhe që figurojnë në pronësi të mbajtësve të paligjshëm.

**16-Gjetje:** ZVRPP Malësi e Madhe ka bërë pune të pamjaftueshme në Administrimin e praktikave dhe kërkesave në proces të pa përfunduara të cilat prej 3 vitesh deri në 30.09.2017 arrijnë në rreth mbi **60 praktika**, me të ardhura të përfituara pa dhënë shërbimin e faturuar, që kanë sjellë si pasojë mungesën e transparencës së punës ndaj publikut, mos administrimin në arkivë të dokumentacionit, mbajtjen e praktikave të aplikimeve nga specialistët për afate të gjata, në kundërshtim e ligjin nr. 9154, datë 6.1.1993 “Për arkivat” .

**Rekomandim 16.1:** Regjistruesi i ZVRPP Malësi e Madhe, të marrë masat për inventarizimin e dokumentacionit, dhe të evadohen aplikimet e **60** praktikave dhe kërkesave në proces të pa përfunduara prej 4 vitesh deri ne 30.09.2017, që kanë sjellë si pasojë mungesën e transparencës së punës së ZVRPP Malësi e Madhe ndaj publikut, dhe të administrohen në arkivë dokumentacioni përkatës i praktikave, në zbatim të ligjit nr. 9154, datë 6.1.1993 “Për arkivat”, neni 24, germa “b” dhe të neneve 4 e 5, Kapitulli II-të, për “Detyrat e Sekretar-Arkivit të organit shtetëror” dhe “Rregullores për punën me dokumentet administrative të organeve shtetërore”, ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

**17-Gjetje : Me refencë nr. 0089**, regjistruar pasuria 3/84 per sipërfaqen 420 m2 truall me AMTP, **Me refencën nr. 0575**, regjistruar pasuria 1/82 per 2204 m2 Are v.2, f.51, rezulton se nga ZVRPP Malesi e Madhe nuk janë verifikuar elementet e formës dhe të përmbajtjes të Aktit Administrativ AMTP nr. 18, date 10.12.2004 si dhe nuk është plotësuar **shtojca I**, është regjistruar truall me AMTP veprim në papajftueshmëri me VKM nr. 159, date 21.03.2006 dhe me pikën 2-3, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrat të regjistruesit”. Sipas HTR ka dhe ndertesë por nuk evidentohet në KPP dhe nuk ka të dhena per kete ndertesë .

**Rekomandimi 17.1:** ZVRPP Malësi e Madhe per 9 gjetje nga auditimi përcaktuar si më sipër, të marrë masa që në bazë të pikës 1, neni 5; pikës 1 neni 49 dhe nenit 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi dhe njekohësisht per pasuritë e perfituara me AMTP deri në vitn 2008 të kërkojë edhe një here pranë institucionit vendor Bashkisë, konfirmimin me të dhena të pasurive përfituar me AMTP si dhe për pasuritë perfituar me ndryshim zeri, si dhe per ndertesat brenda pasurive të pa evidentuara sipas refencave **0089, 0575**, deri në plotësimin e dokumentacionit te duhur ligjor dhe regjistrimin AMTP të konfirmuara ligjerisht nga institucioni vendor cilet e kanë në kopesencë.

**18- Gjetje:** ZVRPP Malesi e Madhe për **1 rast**, me **referencën nr. 0495**, ka regjistruar pasuritë 1/158/1, 1/158/2 dhe 1/158/3 pa pasur plan rievimi, pa certifikatë të gjendjes familjare datë 01.08.1991 dhe pa konfirmim se subjekti është subjekt i trajtimit me tokë, **duke vepruar me regjistrim të pasurive me AMTP në kundërshtim me udhëzimin nr. 2, datë 08.04.2009, me VKM nr. 994, datë 09.12.2015, me Udhëzimin KM nr. 2, date 12.09.2012** “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të

procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruarit”, *per regjistrimin e akteve administrative në zbatim të neneve 44-45 të ligjit 33, date 21.03.2012 sipas nenit 193 të KCRSH.*

**Rekomandimi 18.1:** ZVRPP Malesi e Madhe të marrë masa që në bazë të pikës 1, neni 5; pikës 1 neni 49 dhe nenit 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi dhe njekohësisht për pasuritë e përfituara me AMTP deri në vitin 2008 të kërkojë edhe një herë pranë institucionit vendor Bashkise konfirmimin e pasurive përfitur me AMTP, si dhe për pasuritë e përfituara me ndryshim zëri kadastral, gjithashtu edhe për ndërtesat brenda pasurive të pa evidentuara sipas referencave **0495**, deri në plotësimin e dokumentacionit të duhur ligjor dhe regjistrimin AMTP-ve të konfirmuara ligjërisht nga institucioni vendor.

**19- Gjetje: Me referencën nr.0596**, nga ZVRPP Malesi e Madhe nuk janë verifikuar elementet e regjistruar pasuria 1/239 per sipërfaqen prej 985 m<sup>2</sup> dhe brenda parceles ka ndertim dhe nuk evidentohet në KPP. Rezulton se ka një diferencë sipërfaqesh LN-AMTP, për të cilën nuk është kërkuar deklarate per heqje dore nga subjekti perfitues, për sipërfaqen e tepërt, si dhe nuk është plotësuar *shtojca 1*, vepruar në *kundërshtim me udhëzimin nr.2, date 08.04.2009 dhe VKM nr. 994, date 09.12.2015, në kundërshtim me Udhëzimin KM nr. 2, date 12.09.2012 per regjistrimin e akteve administrative në zbatim të neneve 44-45 të ligjit 33, date 21.03.2012 sipas nenit 193 të KC RSH.*

**Rekomandimi 19.1:** ZVRPP Malesi e Madhe per **1 rast**, percaktuar si me siper, të marrë masa që në bazë të pikës 1, neni 5; pikës 1 neni 49 dhe nenit 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi dhe njekohësisht per pasuritë e perfituara me AMTP deri në vitin 2008 të kërkojë edhe një here pranë institucionit vendor Bashkise konfirmimin me të dhena të pasurive përfitur me AMTP si dhe për pasuritë perfituar me ndryshim zeri, si dhe per ndërtesat brenda pasurive të pa evidentuara sipas referencave **0596**, deri në plotësimin e dokumentacionit te duhur ligjor dhe regjistrimin AMTP të konfirmuara ligjerisht nga institucioni vendor cilet e kanë në kopetencë.

**20-Gjetje: Me Referencën nr. 0215**, regjistruar pasuria 1/3 truall 250 me AMTP nr. 84 si dhe pasuritë: nr. 1/145, 1/247/1, 1/247/2 dhe 1/247/3, nuk rezulton të kete plane rilevimi dhe nga krahasimi sipërfaqes në AMTP tokë are prej 6186 m<sup>2</sup> me regjistrimet në KPP **rezulton të jenë regjistruar me pak 953 m<sup>2</sup>** dhe sipas shenimeve në KPP ne seksionin përshkrimi I pasurisë pasuritë 1/247 dhe 1/247/3 janë ndare nga Autostrada nderkohe nuk ka asnje shënim per pasuritë e shpronësuar dhe janë leshuar certifikata, duke perfituar sipërfaqen e shpronësuar. Sikurse evidentohet nuk rezulton të jetë bere azhornimi në HTR dhe kryerjen e veprimeve në kartela, gjithashtu në dokumentacionin e kësaj dosje mungon: certificate të gjendjes familjare date 01.08.1991 dhe plan rilevimi si dhe nuk ka shkresë nga bashkia per dergimin e AMTP-së, vepruar *në kundërshtim me udhëzimin nr.2, date 08.04.2009 dhe VKM nr. 994, date 09.12.2015, në kundërshtim me Udhëzimin KM nr. 2, date 12.09.2012 per regjistrimin e akteve administrative në zbatim të neneve 44-45 të ligjit 33, date 21.03.2012 sipas nenit 193 të KC RSH*, me pikën 2-3, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruarit”.

**Rekomandimi 20.1:** ZVRPP Malesi e Madhe për **1 rast**, percaktuar si me siper, të marrë masa që në bazë të pikës 1, neni 5; pikës 1 neni 49 dhe nenit 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi dhe njekohësisht per pasuritë e perfituara me AMTP deri në vitin 2008 të kërkojë edhe një here pranë institucionit vendor Bashkise konfirmimin me të dhena të pasurive përfitur me AMTP si dhe për pasuritë perfituar me ndryshim zeri, si dhe per ndërtesat brenda pasurive të pa evidentuara sipas referencave **0215**, deri në plotësimin e dokumentacionit te duhur ligjor dhe regjistrimin AMTP të konfirmuara ligjerisht nga institucioni vendor cilet e kanë në kopetencë.

**21- Gjetje: Me referencën nr. 0438 dhe 0574** pasuria 3/133. V.1, faqe 2008 .Nga ZVRPP Malesi e Madhe nuk janë verifikuar elementet e formës dhe të përmbajtjes të Akteve Administrative

AMTP sipas referencave evidentuar me lart, si dhe nuk është plotësuar *shtojca 1*, duke regjistruar pasurinë dhe duke dhene certificate me pretendimin se është tokë are dhe jo vreshte, si dhe është hequr kufizimi I vendosur pa argumentim ligjor, *duke vepruar në kundërshtim me udhëzimin nr.2, date 08.04.2009 dhe VKM nr. 994, date 09.12.2015, në kundërshtim me Udhëzimin KM nr. 2, date 12.09.2012 per regjistrimin e akteve administrative në zbatim të neneve 44-45 të ligjit 33, date 21.03.2012 sipas nenit 193 të KC RSH*, me pikën 2-3, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruarit”.

**Rekomandimi 21.1:** ZVRPP Malesi e Madhe per **2 raste** percaktuar si me siper, të marrë masa që në bazë të pikës 1, neni 5; pikës 1 neni 49 dhe nenit 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi dhe njekohësisht per pasuritë e perfituara me AMTP deri në vitn 2008 të kërkojë edhe një here pranë institucionit vendor Bashkise konfirmimin me të dhena të pasurive përfituar me AMTP si dhe për pasuritë sipas refrencave *0438 dhe 0574*, deri në plotësimin e dokumentacionit te duhur ligjor dhe regjistrimin AMTP të konfirmuara ligjerisht nga institucioni vendor cilet e kanë në kopetencë.

**22. Gjetje:** *Me refencën nr. 0592*, regjistruar pasuria 3/210 per siperfaqen 710 m2. Nga ZVRPP Malesi e Madhe nuk janë verifikuar elementet e formës dhe të përmbajtjes të Akteve Administrative AMTP sipas referencave evidentuar me lart si dhe nuk është plotësuar *shtojca 1*, nga ZVRPP është bërë regjistrimi i pasurisë, edhe përse bashkia ka konfirmuar se per pasurinë që kerkohet të regjistrohen nuk ka të dhena, ka mosperputhshmeri të të dhenave me hartën per pasurinë 245/5 ku mbivendoset pasuria 3/210. Nuk konfirmohet nga Komuna se M D ka qene subjekt i ligjit ligjit 7501. Gjithashtu *është hequr kufizimi i vendosur pa argumentim ligjor, duke vepruar në kundërshtim me udhëzimin nr.2, date 08.04.2009 dhe VKM nr. 994, date 09.12.2015, në kundërshtim me pikën 2-3, Udhëzimin KM nr. 2, date 12.09.2012 per regjistrimin e akteve administrative në zbatim të neneve 44-45 të ligjit 33, date 21.03.2012 sipas nenit 193 të KC RSH*. Brenda parceles ndodhet ndertesa dhe nuk evidentohet në KPP.

**Rekomandimi 22.1:** ZVRPP Malesi e Madhe per **1 rast**, percaktuar si me siper, të marrë masa që në bazë të pikës 1, neni 5; pikës 1 neni 49 dhe nenit 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi dhe njekohësisht per pasuritë e perfituara me AMTP deri në vitn 2008 të kërkojë edhe një here pranë institucionit vendor Bashkise konfirmimin me të dhena të pasurive përfituar me AMTP si dhe për pasuritë perfituar me ndryshim zeri, si dhe per ndertesat brenda pasurive të pa evidentuara sipas refencës *0592*, deri në plotësimin e dokumentacionit te duhur ligjor dhe regjistrimin AMTP të konfirmuara ligjerisht nga institucioni vendor cilet e kanë në kopetencë.

**23-Gjetje:** *Me refencën nr. 0578*, regjistruar pasuria sipas AMTP nr. 123, date 11.08.2008, dërguar për regjistrim në ZVRPP nga Komuna Kastrat, ku konstatohet se mungon Certificate gjendjes familjare viti 30.04.1993, plani rilevimi i pa nëshkruar nga Bashkia, sa vepruar në kundërshtim me udhëzimin nr. 2. date 08.04.2009 dhe VKM nr. 994, date 0.12.2015 dhe *Udhëzimin KM nr. 2, date 12.09.2012 per regjistrimin e akteve administrative në zbatim të neneve 44-45 të ligjit 33, date 21.03.2012 duke vepruar në kundërshtim me udhëzimin nr.2, date 08.04.2009 dhe VKM nr. 994, date 09.12.2015.*

**Rekomandimi 23.1:** ZVRPP Malesi e Madhe per **1 rast**, përcaktuar si më sipër, të marrë masa që në bazë të pikës 1, neni 5 ndhe nenit 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi dhe njekohësisht per pasuritë e perfituara me AMTP deri në vitn 2008 të kërkojë edhe një here pranë institucionit vendor Bashkise konfirmimin me të dhena të pasurive përfituar me AMTP si dhe për pasuritë perfituar me ndryshim zeri, sipas refencës *0578*, deri në plotësimin e dokumentacionit te duhur ligjor dhe regjistrimin AMTP të konfirmuara ligjerisht nga institucioni vendor cilet e kanë në kopetencë.

**24-Gjetje:** *Me refencën nr. 580, date 28.05.2015 regjistruar pasuria 2/213*, Pemtores +truall me bashkim pasurish. Regjistrimi pasurisë 2/213, Pemtores+truall me sipërfaqe 1074 m<sup>2</sup>, nga e cila



truall 300 m<sup>2</sup> dhe ndërtesë me sipërfaqe 99 m<sup>2</sup>, është bërë në kundërshtim me UKM nr. 2, date 08.04.2009 dhe VKM nr. 994, date 09.12.2015, në kundërshtim me Udhëzimin KM nr. 2, date 12.09.2012 per regjistrimin e akteve administrative në zbatim të neneve 44-45 të ligjit 33, date 21.03.201, dhe regjistrimi është bërë me ndryshim zerin kadastral pa u miratuar nga organet përkatëse, si dhe në KPP, në seksionin përkatës nuk është vendosur (Trajtuar në faqet 10-79, të Projektraportit të Auditimit).

**Rekomandimi 24.1:** ZVRPP Malesi e Madhe per **1 rast**, percaktuar si me siper, të marrë masa që në bazë të pikës 1, neni 5 dhe nenit 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi dhe njekohësisht per pasuritë e perfituara me AMTP deri në vitn 2008 të kërkojë edhe një here pranë institucionit vendor Bashkise konfirmimin me të dhena të pasurive përfituar me AMTP si dhe për pasuritë perfituar me ndryshim zeri, sipas refencave **0580**, deri në plotësimin e dokumentacionit te duhur ligjor dhe regjistrimin AMTP të konfirmuara ligjerisht nga institucioni vendor cilet e kanë në kopetencë.

**25. Gjetje:** Në 6 raste që i përkasin ZK 3982 Bajze, sipas referencave nr. 0001, 002, 0035,0594, 0040, 0583, 0044, janë regjistruar pasuri të përfituara nga ligji nr.7652, datë 01.12.1992 “Mbi privatizimin e banesave shtetërore”.Këto regjistrime janë kryer sipas kontratave të shitblerjes në disa raste fotokopje, me sipërfaqe të pa evidentuara, me mungesa të planimetrive të apartamenteve dhe ndërtesave, pa akte noteriale dhe me dokumente të panoterizuara fotokopje dhe mungesa si formulari nr 1, 2 dhe 3, me mungesa në treguesit tekniko-ekonomikë; mungesa të dokumentitjustifikues të shlyerjes së vlerës së privatizimit, me mungesa tërësore të dokumentacionit të privatizimit.Në pjesën me të madhe ishin lëshuar çertifikata pronësie, në kundërshtim me Rregulloren e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme nr.184, datë 08.04.1999, Kreu IV, pika 7, në lidhje me regjistrimin e pasurive përfituar nga Ligji nr.7652, datë 01.12.1992.

**Rekomandimi 25.1:** Regjistruesi i ZVRPP Malësi e Madhe bazuar në shkeljet e konstatuara, për pasuritë në ZK 3982”, sipas referencave nr. 0001, 002, 0035,0594, 0040, 0583, 0044, në lidhje me regjistrimin e pasurive përfituar nga Ligji nr.7652, datë 01.12.1992, të marrë masa për të kërkuar nga personat përfitues në çdo rast të paraqitur dokumentacionin origjinal mbi të cilët është kryer regjistrimi i këtyre pasurive, si dhe (kontratave të shitblerjesjo fotokopje), me dokumentacion të noterizuar(planimetrinë e dokumentacioni tjetër ndihmës), evidentim të sipërfaqeve, me dokumente justifikues të shlyerjes së detyrimeve të noterizuara, në zbatim të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999, Kap. VI-të, pika 2 “Pranimi i dokumenteve për regjistrim”.

**26. Gjetje:** ZVRPP Malesi e Madhe sipas referencave: nr. 0054 regjistruar pasuria 2/22/ND Ndërtesë Magazine e ish Konsumit dhe zyra truall 160 m2 dhe ndertim 160 m2, volumi 1, faqe 142 dhe kjo pasuri ka vijuar me regjistrim në v.1, faqe 143 dhe 144 N1 dhe N2 dhe me me refencën nr. 0055, në emer të F Ç regjistruar njesi objekt magazine v.1, faqe 143 me siperfaqe 30 m2 dhe në me refencën nr. 0057 emer të A G është blere dhe regjistruar nje siperfaqe njësi 55 m2 dhe nuk rezulton të lenë te percaktuara mardheniet me truallin për siperfaqen e truallit të blere me privatizim. Ne praktikën e regjistrimit nuk gjendet i plotë dokumentacioni i privatizimit të njesive në kundërshtim me ligjinPrivatizimit nr. 7512, datë 10.08.1991 me ndryshimet e mëvonshme, dhe rregulloren nr. 184, datë 08.04,1999, nuk rezultojnë të percaktuara marrdheniet e pronësisë per truallin me siperfaqe 160 m2, duke vepruar në papajtueshmëri me pikën 2-3, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrat të regjistruesit”.

**Rekomandimi 26.1:** Regjistruesi i ZVRPP Malësi e Madhe bazuar në shkeljet e konstatuara, për pasuritë në ZK 3982”,sipas referencave nr. 0054, 0055, dhe 0057, në lidhje me regjistrimin e pasurive përfituar nga Ligji nr. 7512, date 10.08.1991 me ndryshimet e mevonshme dhe ligjin 7652, datë 01.12.1992, të marrë masa që në bazë të pikës 1, neni 5 dhe nenit 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi deri në plotesimin e dokumentacionit ligjor në lidhje me marrdheniet e

pronesise se truallit, në zbatim të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999, Kap. VI-të, pika 2 “Pranimi i dokumenteve për regjistrim”.

**27-Gjetje:** Nga ZVRP Malësi e Madhe rregjistruar sipas refencës nr. 0187, pasuria nr. 3/280, v.4, faqe 101 truall 754 m<sup>2</sup> dhe ndërtim 482 në kundërshtim me dispozitat ligjore të përcaktuara nga ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar duke regjistruar parcelë mbi 500 m<sup>2</sup>, me nje diferencë prej 254 m<sup>2</sup> me ndryshim zeri kadastral nga arë në truall dhe nuk jane kryer veprimet në kartela si pasuri toke arë.

**Rekomandimi 27.1:** Regjistruesi i ZVRPP Malësi e Madhe të marrë masa që në bazë të pikës 1, neni 5 dhe nenit 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë në ZK 3982 “Bajzë”, sipas referencës 0187 deri në miratimin e ndryshimit të zërit Kadastral nga organet që e kanë në kopetencë dhe regjistrimin në KPP si tokë arë dhe jo truall.

**28-Gjetje:** Nga ZVRPP Malësi Madhe janë regjistruar pasuri me leje legalizimi sipas referencës nr. 593, pa u përcaktuar mardheniet me truallin dhe nuk janë kryer veprimet në KPP për vendosjen e Hipotekës Ligjore, në kundërshtim me ligjin 33/2012, 21.03.2012.

**Rekomandimi 28.1:** Regjistruesi i ZVRPP Malësi e Madhe të marrë masa që në bazë të pikës 1, neni 5 dhe nenit 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë në ZK 3982 “Bajzë”, sipas referencës nr. 593 deri në kryerjen e veprimeve për vendosjen e hipotekës ligjore dhe regjistrimin në KPP seksionin E për marrëdhëniet me truallin

**29-Gjetje:** ZVRPP Malësi e Madhe ka regjistruar leje ndërtimi rikonstruksion objekti, duke regjistruar në pronësi të subjektit E.K pasurinë nr. 2/121-Nd<sub>3</sub>, ndërtesë me sipërfaqe 114 m<sup>2</sup> v. 3, faqe 29, lëshuar certifikatë pronësie me datë 16.10.2017, rezulton tjetërsimi i pasurisë shtet është bërë në mungesë të dokumentacionit të fitimit të pronësisë. Gjithashtu Leja e shfrytëzimit është marr me datë 13.04.2001 dhe regjistrimi është bërë me datë 16.10.2017, duke e regjistruar me vonesë në kundërshtim me nenin 38 dhe 39 të ligjit 33/2012 për mos regjistrimin në afat të aktit, për të cilin llogaritet detyrimi i penalitetit për vonesën në regjistrim, në vlerën 300,000 lekë për tu paguar nga subjekti.

Sikurse evidentohet rezulton tjetërsimi i pasurisë “shtet” objekti me sipërfaqe 114 m<sup>2</sup>, duke këluar në pronësi të E.K dhe shtuar sipërfaqja për 20 m<sup>2</sup> nga sipërfaqja ekzistuese, e llogaritur sipas çmimit të vleresimit sipas kostos së Entit Banesave, rezulton e vlerësuar në shumën 114 m<sup>2</sup> x 40,500 = 4,617,000 lekë, që përbën dëm ekonomik dhe detyrim financiar, për tu arkëtuar nga subjekti. Gjithashtu nuk rezulton të jenë përcaktuar mardheniet e truallit me dhurim apo me shitje në zbatim të rregullores nr. 184, datë 08.04.1999, ndërsa për përdorimin e truallit shtet llogaritet qiraja për 50 lekë m<sup>2</sup> dhe për tre vitet nën auditim për 33 muaj llogaritet detyrim për tu paguar në vlerë prej 114 m<sup>2</sup> x 50 lekë/m<sup>2</sup> -5700 lekë në muaj ose për 33 muaj x 5700 lekë në një vlerë për zhdëmtim prej 188,100 lekë.

Pasuria është regjistruar me leje ndërtimi për konstruksion në kundërshtim me dispozitat ligjore të përcaktuara nga ligjit të Urbanistikës nr. 8405, datë 17.09.1998, me ndryshime, në kundërshtim me ligjin nr. 10119, datë 23.04.2009 me ndryshime dhe udhëzimin nr. 3, datë 3.10.2012 Kriteret dhe procedurat për regjistrimin e lejeve të ndërtimit, duke regjistruar pasuri shtet në favor të subjektit privat pa dokument pronësie dhe pa u përcaktuar mardhëniet me truallin, duke i shkaktuar një dëm ekonomik shtetit në vlerën prej 5,105,000 lekë (.).

**Rekomandimi 29.1:** ZVRPP Malesi e Madhe, Regjistruesi, në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe nenit 59 të Ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” të marrë masa për nxjerrjen e urdhrat të kufizimit të pasurisë p. 2/121-ND3 ndërtesë me sipërfaqe 114 m<sup>2</sup> v,3, faqe 29, përfituar me leje ndërtimi nga E.K sipas referencës nr. 0597, deri në plotësimin e dokumentacionit teknik ligjor.

**30-Gjetje:** ZVRPP Malësi e Madhe ka regjistruar pasurinë nr. 3/132, truall 395 dhe ndërtim 275 v.1, faqe 207, sipas refrencës nr. 193, rezulton se Urdhri i Regjistruesit shprehet vetëm për regjistrimin e tokës arë me sipërfaqe 395 m<sup>2</sup> në emër të A.H dhe nuk shprehet për ndarjen e

pasurisë 3/ 130 me sipërfaqe 9238 m<sup>2</sup> dhe ndryshimin e zërit kadastral nga tokë arë në tokë truall, regjistrim i kryer bazuar në lejen e ndërtimit, ku konstatohet ***mungesë e dokumentacionit tekniko ligjor urbanistik, si dhe është regjistruar në në mospërputhje me lëjën e ndërtimit sipërfaqja e objektit prej 8 m<sup>2</sup>***. Origjina e pasurisë rrjedh nga AMTP nr. 30, date 21.01.2005, nga ku rezulton se ***ka mungesë të dokumentacionit tekniko ligjorë, konkretisht: Plan Rilvimi nuk ka konfirmimin e Bashkisë Koplík, mungon certifikata familjare e datës 01.8.1991. Vepruar në kundërshtim me nenet 24, 38 të ligjit nr. 7843, date 13.07.1994***, me ndryshimet e mëvonshme, me nenet 25 e 45, të ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, me udhëzimin nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit”.

**Rekomandimi 30.1:** ZVRPP Malësi e Madhe, Regjistruesi, në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të Ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” të marrë masa për nxjerrjen e urdhërit të kufizimit të pasurisë nr. 3/132 v.1, faqe 207, ***truall me sipërfaqe 395 m<sup>2</sup> dhe ndertesë më sipërfaqe 275 m<sup>2</sup>*** përfituar me leje ndërtimi, deri në plotësimin e dokumentacionit të duhur ligjor.

**31-Gjetje:** ZVRPP Malsi e Madhe ***në një rast***, ka kryer veprime në (KPP) për pasurinë: nr. 282/1, truall me sipërfaqe 415 m<sup>2</sup> volum 2, faqe 38, ZK 1010, duke i ofruar shërbimin e kërkuar subjektit në kushtet kur: ***Për VKKP nr. 143, ish/Agjencia Rajonale e KKP Qarku Shkodër me shkresën nr. 908/29 datë 17.07.2008 në përgjigje të kërkesës së ZVRPP Malsi e Madhe nr. 461. datë 15.07.2008, shprehet se nuk ka vendim me të dhënat e kërkuar pra, gjithashtu bashkëlidhur këtij vendimi nuk ndodhet procesverbal i marrjes në dorëzim të pronës, nuk janë bërë verifikimet e elementeve dhe të dhënave të aktit, i cili është regjistruar më parë në regjistrin e pasurive të paluajtshme.*** Veprim në papajtueshmëri me nenin 24, pika “a” të Ligjit nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” ndryshuar, pikat c dhe e të neni 20 të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, me pikën 9.4, të kreut të IV, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, me pikën 2 paragrafi 2, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit”.

**Rekomandim 31.1:** Regjistruesi i ZVRPP Malsi e Madhe të marrë masa, që në bazë të pikës a neni 25, pikës dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, pikës 5.2.2, të kreut të VI, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurië nr. 282/1, volum 2, faqe 38, ZK 1010 deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

**32-Gjetje:** ZVRPP Malsi e Madhe ***në një rast***, ka kryer veprime në (KPP) për pasurinë: për pasurinë nr. 197/2, volum 1, faqe 13 truall me sipërfaqe 4800 m<sup>2</sup>, ndërtesë 91 m<sup>2</sup>, duke ofruar shërbimin e kërkuar subjektit, ***heqjen e kufizimit pa plotësuar kushtin për të cilin ishte vendosur.*** Në VKKKP nr. 26, datë 27.07.1995. Pjesa vendosi pika 1. B Sanksionon se: ***“Shteti (BSPSH) Sindikatat, do të lidhin kontratë qiramarrje me ta për një periudhë 3 vjeçare , mbas kësaj periudhe shteti do të kthej plotësisht truallin dhe objekti”, gjë e cila nuk rezulton të ketë ndodhur pasi, në dosje nuk ndodhet asnjë dokument që të provoj këtë fakt.*** Gjithashtu sa cituam ***bashkëlidhur këtij vendimi nuk ndodhet procesverbal i marrjes në dorëzim të pronës Si dhe nuk janë bërë verifikimet e elementeve dhe të dhënave të aktit, i cili është regjistruar më parë në regjistrin e pasurive të paluajtshme.*** Veprim në papajtueshmëri me nenin 24, pika “a” të Ligjit nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” ndryshuar, pikat c dhe e të neni 20 të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, me pikën 9.4, të kreut të IV, pikat 5.2.2 paragrafi i parafundit i kreut VI të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, me pikën 2 paragrafi 2, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit”.

**Rekomandim 32.1:** Regjistruesi i ZVRPP Malsi e Madhe të marrë masa, që në bazë të pikës a neni 25, pikës dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të

Paluajtshme”, pikës 5.2.2, të kreut të VI, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurië nr. 197/2, volum 1, faqe 13 ZK 3834 deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

**33-Gjetje:** ZVRPP Malsi e Madhe në 1 rast, ka kryer veprime në (KPP) për pasurinë nr. 204/5, Pyll me sipërfaqe 3000 m<sup>2</sup> volum 1, faqe 30, duke ofruar shërbimin e kërkuar subjektivit, *pa e hequr më par kufizimin pa plotësuar kushtin për të cilin ishte vendosur*. Gjithashtu sa cituam *bashkëlidhur këtij vendimi nuk ndodhet procesverbal i marrjes në dorëzim të pronës. Si dhe nuk janë bërë verifikimet e elementeve dhe të dhënave të aktit, i cili është regjistruar më parë në regjistrin e pasurive të paluajtshme*. Veprim në papajtueshmëri me nenin 24, pika “a” të Ligjin nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” ndryshuar, pikat c dhe e të nenit 20 të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, me pikën 9.4, të kreut të IV, pikat 5.2.2 paragrafi i parafundit i kreut VI të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, me pikën 2 paragrafi 2, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit”.

**Rekomandim 33.1:** Regjistruesi i ZVRPP Malsi e Madhe të marrë masa, që në bazë të pikës a neni 25, pikës dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, pikës 5.2.2, të kreut të VI, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurië nr. 204/5, volum 1, faqe 30 ZK 3834 deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

**34-Gjetje nga auditimi:** ZVRPP Malsi e Madhe në një rast, ka kryer veprime në (KPP) për pasurinë nr. 212/3 me sipërfaqe 400 m<sup>2</sup> kullotë, volum 1, faqe 75, duke ofruar shërbimin e kërkuar subjektivit *pa e hequr më par kufizimin pa plotësuar kushtin për të cilin ishte vendosur kufizimi*. Gjithashtu *nuk janë bërë verifikimet e elementeve dhe të dhënave të aktit, i cili është regjistruar më parë në regjistrin e pasurive të paluajtshme*. Veprim në papajtueshmëri me nenin 24, pika “a” të Ligjin nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” ndryshuar, pikat c dhe e të nenit 20 të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, me pikën 9.4, të kreut të IV, pikat 5.2.2 paragrafi i parafundit i kreut VI të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, me pikën 2 paragrafi 2, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit”.

**Rekomandim 34.1:** Regjistruesi i ZVRPP Malsi e Madhe të marrë masa, që në bazë të pikës a neni 25, pikës dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, pikës 5.2.2, të kreut të VI, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurië nr. 212/3, volum 1, faqe 75 ZK 3834 deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

**35-Gjetje:** ZVRPP Malsi e Madhe në një rast, ka kryer veprime në (KPP) për pasurinë nr. 196/2-ND, truall+ ndërtesë me sipërfaqe 600 m<sup>2</sup> truall, 106 m<sup>2</sup> ndërtesë volum 1, faqe 82, ndërtesa vjen nga volum 3 faqe 227 duke ofruar shërbimin e kërkuar subjektivit *pa e hequr më par kufizimin pa plotësuar kushtin për të cilin ishte vendosur kufizimi*. Ndërtesa e cila vjen nga volum 3 faqe 227 është në pronësi Shtet, në posedim nga Sindikata e pavarur sa përshkruhet në seksionin D të kartelës ku për të cilën bazuar në Vendimin e KKP nr. 99 datë 25.02.1997 subjektivit i lind e drejta e parablerjes. Gjithashtu *nuk janë bërë verifikimet e elementeve dhe të dhënave të aktit, i cili është regjistruar më parë në regjistrin e pasurive të paluajtshme*. Veprim në papajtueshmëri me nenin 24, pika “a” të Ligjin nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” ndryshuar, pikat c dhe e të nenit 20, pika a neni 25 të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, me pikën 9.4, të kreut të IV, pikat 5.2.2 paragrafi i parafundit i kreut VI të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 “Për punën e zyrës së

regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, me pikën 2 paragrafi 2, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruarit”. (*Trajtuar në faqet 5-10, të Raportit përfundimtar të Auditimit*).

**Rekomandim 35.1:** Regjistruari i ZVRPP Malsi e Madhe të marrë masa, që në bazë të pikës a neni 25, pikës dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, pikës 5.2.2, të kreut të VI, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurië nr. 196/2-ND, volum 1, faqe 82, nr. 196/4 volum 1 faqe 80, nr. 1963 volum 1 faqe 80 ZK 3834 deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

**36-Gjetje:** ZVRPP Malsi e Madhe në një rast, ka kryer veprime në (KPP) për pasurinë, nr. 211/18, pyll me sipërfaqe 13790 m<sup>2</sup>, e cila vijon volum 8 faqe 45-46, volum 1, faqe 108, duke ofruar shërbimin e kërkuar subjektit, *hequr fshirë kufizimin pa plotësuar kushtin për të cilin ishte vendosur*. Gjithashtu nuk janë bërë verifikimet e elementeve dhe të dhënave të aktit, i cili është regjistruar më parë në regjistrin e pasurive të paluajtshme. Veprim në papajtueshmëri me nenin 24, pika “a” të Ligjit nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” ndryshuar, pikat c dhe e të nenit 20 të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, me pikën 9.4, të kreut të IV, pikat 5.2.2 paragrafi i parafundit i kreut VI të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, me pikën 2 paragrafi 2, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruarit”.

**Rekomandim 36.1:** Regjistruari i ZVRPP Malsi e Madhe të marrë masa, që në bazë të pikës a neni 25, pikës dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, pikës 5.2.2, të kreut të VI, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurië nr. 211/18, volum 8 faqe 45-46, volum 1, faqe 108 ZK 3438 deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

**37- Gjetje:** ZVRPP Malsi e Madhe në një rast, ka kryer veprime në (KPP) për pasurinë, nr. 220/1 volum 1, faqe 130, duke ofruar shërbimin e kërkuar subjektit në kushtet kur: *të dhënat e sipërfaqes sipas LN 2013 e pasqyruar në KPP, nuk përputhen me ato të aktit të fitimit të pronësisë apo të së drejtës reale, të përdorur për kryerjen e regjistrimit, si dhe bashkëlidhur dëshmisë së trashëgimisë mungon plan rievimi, gjithashtu pas plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor, nuk janë respektuar afatet e kryerjes së veprimeve, si dhe nga ana e hartografit nuk është kryer hedhja me konture te kuqe prona në hartën e punës*. Veprim në papajtueshmëri me, pikat c dhe e të nenit 20 të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, me pikën 5.1, të kreut të VI, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, me pikën 2 paragrafi 2, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruarit”.

**Rekomandim 37.1:** Regjistruari i ZVRPP Malsi e Madhe të marrë masa, që në bazë të pikës a neni 25, pikës dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, pikës 5.2.2, të kreut të VI, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë nr. 220/1 volum 1, faqe 130, nr. 219/1 volum 1, faqe 131 ZK 3438 deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

**38- Gjetje:** ZVRPP Malsi e Madhe në një rast, ka kryer veprime në (KPP) për pasurinë, nr. 91/3, pyll me sipërfaqe 1158 m<sup>2</sup>, volum 8, faqe 12, *duke kryer veprime mbi pasuritë e kufizuara, pa plotësuar më parë kushtin për të cilin ishte vendosur kufizimi*. Gjithashtu nuk janë bërë verifikimet e elementeve dhe të dhënave të aktit, i cili është regjistruar më parë në regjistrin e pasurive të paluajtshme. Veprim në papajtueshmëri me, pikat c dhe e të nenit 20 të ligjit nr. 33,

datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, me pikën 9.4, të kreut të IV, pikat 5.2.2 paragrafi i parafundit i kreut VI të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, me pikën 2 paragrafi 2, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit”.

**Rekomandim 38.1:** Regjistruesi i ZVRPP Malsi e Madhe të marrë masa, që në bazë të pikës a neni 25, pikës dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, pikës 5.2.2, të kreut të VI, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë nr. 91/3 volum 8, faqe 12, nr. 91/4 volum 8, faqe 13 ZK 3438 deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

**39- Gjetje:** ZVRPP Malsi e Madhe në një rast, ka kryer veprime në (KPP) për pasurinë nr. 204/15, pyll me sipërfaqe 500 m<sup>2</sup>, volum 8, faqe 33, pasuri e cila vijon volum 8 faqe 33-35-36-38-39-40-41-42, *duke kryer veprime mbi pasuritë e kufizuara, pa plotësuar më par kushtin për të cilin ishte vendosur kufizimi.* Gjithashtu nuk janë bërë verifikimet e elementeve dhe të dhënave të aktit, i cili është regjistruar më parë në regjistrin e pasurive të paluajtshme. Veprim në papajtueshmëri me, pikat c dhe e të nenit 20 të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, me pikën 9.4, të kreut të IV, pikat 5.2.2 paragrafi i parafundit i kreut VI të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, me pikën 2 paragrafi 2, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit”.

**Rekomandim 39.1:** Regjistruesi i ZVRPP Malsi e Madhe të marrë masa, që në bazë të pikës a neni 25, pikës dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, pikës 5.2.2, të kreut të VI, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë nr. 204/15 volum 8, faqe 33, nr. 204/17 volum 8, faqe 35, nr. 204/20 volum 8, faqe 38, nr. 204/24 volum 8, faqe 42 ZK 3438 deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

**40- Gjetje:** ZVRPP Malsi e Madhe në 11 raste, ka kryer veprime në (KPP) për pasuritë sipas pasqyrës nr. X bashkëlidhur projektraportit të auditimit, regjistruar sipas AMTP-ve me sipërfaqe totale 139,045 m<sup>2</sup> në kushtet kur: *Përfituesit e AMTP-ve nuk rezultojnë të kenë qenë subjekte të trajtimit me tokë bujqësore, pasi ju mungon dokumenti certifikata e gjendjes civile të familjes përfituese në datën 1.8.1991 për territoret e ish-kooperativave bujqësore, si dhe në datën 01.8.1991 dhe ndryshimet deri më 1.10.1992 për territoret e ish-ndërmarrjeve bujqësore.* Veprim në papajtueshmëri me pika 4, shkronjën “a” të UKM nr. 2, datë 13.06.2013 “Për mënyrën e procedimit të organeve të administratës publike, për pasuritë e paluajtshme, të fituara me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP)” i ndryshuar.

**Rekomandim 40.1:** Regjistruesi i ZVRPP Malsi e Madhe të marrë masa, që në bazë të pikës a neni 25, pikës dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, pikës 5.2.2, të kreut të VI, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi, për pasuritë e evidentuara në pasqyrën nr. 4, ZK 1010 A bashkëlidhur projektraportit të auditimit, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

**41- Gjetje:** ZVRPP Malsi e Madhe në një rast, ka kryer veprime në (KPP) për pasurinë nr. 112/3, arë me sipërfaqe 3400 m<sup>2</sup> volum 5, faqe 124 regjistruar sipas AMTP nr. 189, duke ofruar shërbimi e kërkuar subjektit, në kushtet kur: *Në plan rilevimin e dërguar nga komuna i përgatitur më datë 13.12.2014, rezulton se mes dy pasurive nr. 112 dhe nr.114 ndodhet pasuri me nr. 113 rrugë e cila është korigjuar dhe spostuar me vija të kuqe mbi pasurinë nr. 114 duke hedhur mbi rrugë pronën 112/3 regjistruar volum 5, faqe 124 arë me sipërfaqe 3400 m<sup>2</sup>, pasuria e llojit rrugë është regjistruar volum 1 faqe 113 nr. 113 rrugë pronësi shtet me sipërfaqe 659 m<sup>2</sup>.* Veprim në papajtueshmëri me pikat c dhe e të nenit 20 të ligjit nr. 33, datë

29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, në kundërshtim me pikat 10.3 dhe 10.5, të kreut të IV, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar.

**Rekomandim 41.1:** Regjistruesi i ZVRPP Malsi e Madhe të marrë masa, që në bazë të pikës a neni 25, pikës dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, pikës 5.2.2, të kreut të VI, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 112/3, arë me sipërfaqe 3400 m<sup>2</sup> volum 5, faqe 124 ZK 1010 deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

**42- Gjetje:** ZVRPP Malsi e Madhe në një rast, ka kryer veprime në (KPP) për pasurinë nr. 965, volum 5, faqe 137 arë me sipërfaqe 11,244 m<sup>2</sup>, pasuri e regjistruar sipas AMTP nr. 154, duke ofruar shërbimi e kërkuar subjektit, në kushtet kur: *Në planrilevimin bashkëlidhur dokumentacionit, brenda pasurisë nr. 965 figurojnë dy objekte për të cilat, në shtojcën nr. 3 punonjësit e ZVRPP nuk shprehen për statusin juridik të këtyre objekteve, si edhe pas hedhjes së pronës me konturet e kuqe në hartën e punës.* Gjithashtu përfituesi i AMTP-së 154 nuk rezulton të ketë qenë subjekt i trajtimit me tokë bujqësore, pasi mungon dokumenti certifikata e gjendjes civile të familjes përfituese në datën 1.8.1991 për territoret e ish-kooperativave bujqësore, si dhe në datën 01.8.1991 dhe ndryshimet deri më 1.10.1992 për territoret e ish-ndërmarrjeve bujqësore. Veprim në papajtueshmëri pikat c dhe e të nenit 20 të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” me pika 4, shkronjën “a” të UKM nr. 2, datë 13.06.2013 “Për mënyrën e procedimit të organeve të administratës publike, për pasuritë e paluajtshme, të fituara me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP)” i ndryshuar.

**Rekomandim 42.1:** Regjistruesi i ZVRPP Malsi e Madhe të marrë masa, që në bazë të pikës a neni 25, pikës dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, pikës 5.2.2, të kreut të VI, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 965, volum 5, faqe 137, nr. 971 volum 5, faqe 138 ZK 1010 deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

**43- Gjetje:** ZVRPP Malsi e Madhe në 3 raste, ka kryer veprime në (KPP) për pasuritë regjistruar sipas AMTP-ve nr. 113/1, nr. 2, nr. 25 me sipërfaqe totale 28,826 m<sup>2</sup> duke ofruar shërbimi e kërkuar subjektit, në kushtet kur: *Përfituesit e AMTP-ve nuk rezultojnë të kenë qenë subjekte të trajtimit me tokë bujqësore, pasi ju mungon dokumenti certifikata e gjendjes civile të familjes përfituese në datën 1.8.1991 për territoret e ish-kooperativave bujqësore, si dhe në datën 01.8.1991 dhe ndryshimet deri më 1.10.1992 për territoret e ish-ndërmarrjeve bujqësore.* Veprim në papajtueshmëri me pika 4, shkronjën “a” të UKM nr. 2, datë 13.06.2013 “Për mënyrën e procedimit të organeve të administratës publike, për pasuritë e paluajtshme, të fituara me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP)” i ndryshuar.

**Rekomandim 43.1:** Regjistruesi i ZVRPP Malsi e Madhe të marrë masa, që në bazë të pikës a neni 25, pikës dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, pikës 5.2.2, të kreut të VI, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë: nr. 208/2, volum 4, faqe 214 ZK 3834, nr. 811, volum 4, faqe 232 ZK 3870, nr. 447/1 volum 1, faqe 17 ZK 3870, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

**44-Gjetje:** ZVRPP Malsi e Madhe në një rast, ka kryer veprime në (KPP) për pasuritë nr. 673/3, vol 4 faqe 214 arë me sipërfaqe 22871 m<sup>2</sup>, e cila rrjedh nga bashkimi i pasurive nr. 673 volum 4 faqe 98 e llojit zall me sipërfaqe 24385 m<sup>2</sup> dhe pasurinë nr. 809, volum 4, faqe 156 llojit ranishte me sipërfaqe 40275 m<sup>2</sup>, përfituar sipas AMTP nr. 2, duke ofruar shërbimi e kërkuar subjektit, në kushtet kur: Pasuria nr. 673/3, vol 4 faqe 214 arë me sipërfaqe 22871 m<sup>2</sup> rrjedh nga bashkimi i pasurive nr. 673 volum 4 faqe 98 e llojit zall me sipërfaqe 24385 m<sup>2</sup> në pronësi shtet dhe pasurinë nr. 809 volum 4 faqe 156 llojit ranishte me sipërfaqe 40275 m<sup>2</sup> në pronësi shtet, në mungesë të një akti administrativ në kuptim të ligjit për urbanistikën i ndryshuar dhe të legalizimit i ndryshuar, që të mundësohej ndryshimi i zërit kadastral. Veprim në papajtueshmëri me nenin 24, pika “a” të Ligjit nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të

paluajtshme” ndryshuar, me pikën 5.1 nën pika 8 *ndryshim i gjendjes se përshkrimit te pasurisë*, të kreut të VI, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”.

**Rekomandim 44.1:** Regjistruesi i ZVRPP Malsi e Madhe të marrë masa, që në bazë të pikës a neni 25, pikës dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, pikës 5.2.2, të kreut të VI, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 673/3 volum 4, faqe 214 ZK 3870, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

**45- Gjetje:** ZVRPP Malsi e Madhe **në një rast**, ka kryer veprime në (RH) për pasuritë nr. 3 regjistruar në regjistrin hipotekor nr. 112 datë 20.05.2004 dhe nr. 9 regjistruar në regjistrin hipotekor nr. 113 datë 20.05.2004, duke ofruar shërbimin e kërkuar në kushtet kur: *Pasi pasuritë në fjalë nuk janë objekt i ligjit për rivlerësim sepse zona është në sistemin e regjistrimit hipotekor dhe nuk është në proces regjistrimi fillestar apo në sistemin e ri të regjistrimit.* Veprime këto në papajtueshmëri me nenin 3 të ligjit nr. 81/2016 “Për rivlerësimin e pasurive të pa luajtshme”, si dhe Udhëzimin nr. 19, datë 26.08.2016 “Për procedurat e zbatimit të ligjit nr. 81/2016 “Për rivlerësimin e pasurive të pa luajtshme”.

**Rekomandim 45.1:** Regjistruesi i ZVRPP Malsi e Madhe të marrë masa, që në bazë të pikës a neni 25, pikës dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, pikës 5.2.2, të kreut të VI, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi anulimin e vërtetimit hipotekor për pasuritë nr. 3 regjistruar në regjistrin hipotekor nr. 112 datë 20.05.2004 dhe pasuria nr. 9 regjistruar në regjistrin hipotekor nr. 113 datë 20.05.2004 ZK 3748 Vermosh/ ZK 3839 Vukël, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

**46- Gjetje:** ZVRPP Malsi e Madhe **në një rast**, ka kryer veprime në (KPP) për pasuritë nr. 54/19 ND, nr. 74/21 ND, nr. 74/20 ND volum 8, faqe 54-55-56 përfituar nga Leja e Legalizimit, *duke mos kryer regjistrimin e hipotekës ligjore mbi pasuritë e legalizuara në seksionin (E) të kartelës, deri në miratimin e trullit me VKM, gjithashtu nuk përputhen genplani i dërguar qe shoqeron lejen me planrilevimin e përgatitur nga hartografi.* Veprim në papajtueshmëri me nenin 49, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” me pikat 10.3, 10.4, të kreut të II, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, si dhe shkresës nr. 675 datë 07.03.2017 të ALUIZNIT që ka përcjell aktet për regjistrim.

**Rekomandim 46.1:** Regjistruesi i ZVRPP Malsi e Madhe të marrë masa, që në bazë të pikës a neni 25, pikës dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, pikës 5.2.2, të kreut të VI, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë nr. 54/19 ND, nr. 74/21 ND, nr. 74/20 ND volum 8, faqe 54-55-56 ZK 3834 Vrith, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor dhe miratimin e VKM.

**47- Gjetje:** ZVRPP Malsi e Madhe **në një rast**, ka kryer veprime në (KPP) për pasuritë nr. 75/3 ND, nr. 75/2 ND volum 8, faqe 51-52 përfituar nga Leja e Legalizimit, *duke mos kryer regjistrimin e hipotekës ligjore mbi pasuritë e legalizuara në seksionin (E) të kartelës, deri në miratimin e trullit me Vendim të Këshillit të Ministrave, gjithashtu nuk përputhen genplani i dërguar qe shoqeron lejen me planrilevimin e përgatitur nga hartografi.* Veprim në papajtueshmëri me nenin 49, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” me pikat 10.3, 10.4, të kreut të II, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, si dhe shkresës nr. 7428 datë 05.09.2016 të ALUIZNIT që ka përcjell aktet për regjistrim.

**Rekomandim 47.1:** Regjistruesi i ZVRPP Malsi e Madhe të marrë masa, që në bazë të pikës a neni 25, pikës dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, pikës 5.2.2, të kreut të VI, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër



kufizimi për pasuritë nr. 75/3 ND, nr. 75/2 ND volum 8, faqe 51-52 ZK 3834 Vrith, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor dhe miratimin e VKM.

**48- Gjetje:** ZVRPP Malsi e Madhe **në një rast**, ka kryer veprime në (KPP) për pasurinë nr. 201/1 ND volum 8, faqe 63, përfituar nga Leja e Legalizimit, **duke mos kryer regjistrimin e hipotekës ligjore mbi pasuritë e legalizuara në seksionin (E) të kartelës, deri në miratimin e trullit me Vendim të Këshillit të Ministrave.** Veprim në papajtueshmëri me nenin 49, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” me pikat 10.3, 10.4, të kreut të II, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, si dhe shkresës nr. 7428 datë 05.09.2016 të ALUIZNIT që ka përcjell aktet për regjistrim..

**Rekomandim 48.1:** Regjistruesi i ZVRPP Malsi e Madhe të marrë masa, që në bazë të pikës a neni 25, pikës dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, pikës 5.2.2, të kreut të VI, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 201/1 ND volum 8, faqe 63, ZK 3834 Vrith, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

**49- Gjetje:** ZVRPP Malsi e Madhe, **nuk është marë iniciativa** në çdo kohë me ose pa kërkesën e personave të interesuar, të kërkojë që të bëhet një studim/rilevim për çdo pasuri të paluajtshme, **duke marë shkas nga fakti se për pasuritë përfituar nga Leja e Legalizimit për ZK3834 Vrith, ka mos përputhje genplani i dërguar që shoqëron lejen me planrilevimin e përgatitur nga hartografi dhe me hartën e punës**, dhe pasi të ketë njoftuar personat e interesuar, të korrigjonte hartën kadastrale si rezultat i studimit/rilevimit të lartpërmendur, për të korrigjuar çdo gabim teknik apo material në hartën kadastrale, pa cënuar interesat e ndonjë personi, duke vënë në dijeni personat e interesuar apo personat që kanë të drejta reale mbi sendin. Veprim në papajtueshmëri me nenin 30, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

**Rekomandim 49.1:** Regjistruesi i ZVRPP Malsi e Madhe të marrë masa, që në bazë të pikës a neni 25, pikës dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, pikës 5.2.2, të kreut të VI, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër me qëllim përmirësimin e hartës kadastrale, ku të bëjë një për një kontrollin tekniko/ligjor për çdo pasuri për ZK3834 Vrith, në përputhje me ligjin nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” për të cilat të njoftohet Kontrolli i Lartë i Shtetit për çdo mas të marë deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

**50- Gjetje:** ZVRPP Malsi e Madhe **në një rast**, ka kryer veprime në (KPP) për pasurinë nr. 598, volum 3, faqe 116, me sipërfaqe 496 m<sup>2</sup> truall dhe 496 m<sup>2</sup> objekt, duke ofruar shërbimi e kërkuar subjektit, në kushtet kur: **Në formularin për inventarizimin e pronave të pa luajtshme, sipërfaqja e ndërtesës është 38.25 m<sup>2</sup> ndërsa në (kpp) volum 3 faqe 116 është 496 m<sup>2</sup>, duke pasqyruar objektin më tepër me një diferencë prej 457.75 m<sup>2</sup>.** Veprim në papajtueshmëri me pikat c dhe e të nenit 20, pika a neni 25 të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

**Rekomandim 50.1:** Regjistruesi i ZVRPP Malsi e Madhe të marrë masa, që në bazë të pikës a neni 25, pikës dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, pikës 5.2.2, të kreut të VI, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 598, volum 3, faqe 116, ZK 1010 Aliaj, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

**51-Gjetje:** ZVRPP Malsi e Madhe në vitin 2005 ZK 1010 Aliaj është futur në sistemin e ri të regjistrimit, ku **në 643 raste pasuritë** sipas pasqyrës nr.1- bashkëlidhur projektraportit të auditimit: janë regjistruar **në seksionin (C) të kartelës pronar Shtet dhe në seksionin (E) të kartelës janë regjistruar në posedim me emrat respektivë posedues, me sipërfaqe totale 610 ha, në mungesë të dokumentacionit teknikoligjor** si: Aktet “qira, në përdorim, marrëveshje kufizuese, servitute dhe interesa të tjera (ku përfshihen: uzufukt, enfiteoze, dorezani, administrim, nënqira, qira financiare etj)”, me argumentin se janë evidentuar gjatë fazës së kontrollit dhe përpunimit të terrenit, por për të cilët nuk posedohet dokumentacion në kuptim të nenit 193 të Kodit. Sa më sipër ZVRPP

Malsi e Madhe *nuk ka kryer një për një kontrollin tekniko-ligjor të të gjitha regjistrimeve të kryera në kartelat e pasurive të paluajtshme të reja të hapura nga kompania kontraktore.* Veprime këto në papajtueshmëri me germën “a” e nenit 24, të ligjit nr. 7843, datë 13/07/1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar, me paragrafi e parë të pikës 5.2, të kreut të VI, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”.

**Rekomandim 51.1:** Regjistruesi i ZVRPP Malsi e Madhe të marrë masa, që në bazë të pikës a neni 25, pikës dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, pikës 5.2.2, të kreut të VI, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për *pasuritë* sipas pasqyrës nr.1- bashkëlidhur projektraportit të auditimit: ZK 1010 Aliaj, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

**52- Gjetje:** ZVRPP Malësi e Madhe në vitin 2016 ZK 2220 Koplík është futur në sistemin e ri të regjistrimit, ku në *414 raste pasuritë* sipas pasqyrës nr. 2 bashkëlidhur projektraportit të auditimit: janë regjistruar në seksionin (C) të kartelës pronar Shtet dhe në seksionin (E) të kartelës janë regjistruar në posedim me emrat respektivë posedues, me sipërfaqe totale 145487 m<sup>2</sup>, në mungesë të dokumentacionit tekniko ligjor si: Aktet “qira, në përdorim, marrëveshje kufizuese, servitute dhe interesa të tjera (ku përfshihen: uzufukt, enfiteoze, dorezani, administrim, nënqira, qira financiare etj)”, me argumentin se janë evidentuar gjatë fazës së kontrollit dhe përpunimit të terrenit, por për të cilët nuk posedohet dokumentacion në kuptim të nenit 193 të Kodit. Sa më sipër ZVRPP Malsi e Madhe *nuk ka kryer një për një kontrollin tekniko-ligjor të të gjitha regjistrimeve të kryera në kartelat e pasurive të paluajtshme të reja të hapura nga kompania kontraktore.* Veprime këto në papajtueshmëri me germën pika a neni 25 të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar, me paragrafi e parë të pikës 5.2, të kreut të VI, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”.

**Rekomandim 52.1:** Regjistruesi i ZVRPP Malsi e Madhe të marrë masa, që në bazë të pikës a neni 25, pikës dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, pikës 5.2.2, të kreut të VI, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për *pasuritë* sipas pasqyrës nr. 2- bashkëlidhur projektraportit të auditimit: ZK 2220 Koplík, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

**53-Gjetje:** Në *shumë raste*, punonjësit e ZVRPP Malësi e Madhe, nuk kanë plotësuar *shtojcat 1, 2 dhe 3*, lidhur me verifikimin elementëve të formës dhe të përmbajtjes së Aktit Administrativ, Kontratës Noterale apo Vendimit të Gjykatës, veprim në papajtueshmëri me pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit”.

**Rekomandim 53.1:** Regjistruesi i ZVRPP Malësi e Madhe të marrë masa, që për regjistrimin e pasurive të paluajtshme të verifikojë elementët e formës dhe të përmbajtjes për pasuritë e fituar me vendim gjykatë, akte noterale dhe akte administrative. Të plotësoj shtojcat 1, 2, 3, si dhe të shprehet me shkrim duke arsyetuar regjistrimin e pasurisë së paluajtshme ose refuzimin e tyre.

**54-Gjetje:** Në *shumë raste*, nga hartografët e ZVRPP Malësi e Madhe, nuk janë përgatitur kopje e hartës treguese të regjistrimit (HTR) *ku të përcaktoj me vijëzim me ngjyre të kuqe pozicionin gjeografik të pasurisë*, veprim në papajtueshmëri me pikën 10.6, Kreu i II, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar.

**Rekomandim 54.1:** Regjistruesi i ZVRPP Malësi e Madhe të marrë masa, që për çdo rast për pasuritë e paluajtshme si regjistrime fillestare, ndarje dhe bashkim pasurish të përgatisë planrilevimi nga hartografi i ZVRPP duke e krahasuar me planrilevimin e ardhur nga topografi me licencës.

## **B. MASA SHPËRBLIM DËMI**

bështetur në ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, pjesa VI, kreu I, nenet 105-109 dhe udhëzimin e Ministrit të Financave, nr. 30, datë

27.12.2011”Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Kap IV, -Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, pika 93 dhe Ligjin nr. 33/2012 “Për regjistrimin e parurive të paluajtshme” nga ana e titullarit të njësisë publike, (Nëpunësit Autorizues), të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit nga personat e subjektet përsëgjësë. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabile përfundimtare, me qëllim për shpërblimin e dëmit **në vlerën 42,850,000 lekë**, analizuar si me poshtë:

**1-Gjetje:** ZVRPP Malësi e Madhe në **7 raste** që i përkasin ZK 2220, Qyteti Koplík, ka regjistruar pasuritë e paluajtshme për poseduesit e AMTP-ve përkatëse, me refrencat: nr. 2957, nr. 3005, nr. 2991, nr. 2866, nr. 2868, nr. 2897, nr. 2934, 2970, nr. 2952, nr. 2954, nr. 2977, nr. 2928, *duke mos zbatuar kërkesat ligjore, pasi* regjistrimi i pasurive është kryer duke tjetërsuar pasuritë trual+ndërtesë, të regjistruara më parë në pronësi “shtet”, pët të cilat është bërë ndarja e truallit nga objekti, duke kaluar truallin në pronësi të individëve posedues të AMTP-ve, ndërsa pasuritë ndërtesë me sipërfaqe totale **932 m<sup>2</sup>**, janë hequr nga KPP, për të cilat ZVRPP pretendon se janë regjistruar gabimisht gjatë procesit të kalimit në sistem regjistrimi nga kompania e kontraktuar “D.....” shpk. Heqja nga KPP e këtyre pasurive në pronësi të shtetit, llogaritur sipas kostos së Entit Banesave, për sipërfaqen totale të ndërtimit prej **932 m<sup>2</sup>**, rezulton një **dëm ekonomik në vlerën 37,746,000 lekë** [932 m<sup>2</sup>(sip. totale e ndërt. fshirë nga KPP) x 40,500 lek/m<sup>2</sup>(kosto sips EKB për Koplíkun), sa vepruar **në papajtueshmëri** me shkronjën “a” neni 25 dhe pikën 3 neni 34, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

**Rekomandim:** Regjistruesi i ZVRPP Malësi e Madhe të marrë masa, në bashkëpunim me ZQRPP Tiranë dhe Bashkinë Koplík, të verifikojë dhe të saktësojë me përgjegjësi të lartë, vërtetësinë e këtij problemi, duke dalë me një vendim konkret që përcakton, nëse këto ndërtime(të fshira nga KPP) i përkasin shtetit, apo janë objekte private të ndërtuara pas viti 1991, të regjistruara gabimisht gjatë procesit të kalimit të zonës në sistem regjistrimi, në të kundërt të ndjekë të gjithë hapat ligjorë, deri në arkëtimin e detyrimit financiar, të shkaktuar si dëm ekonomik ndaj shtetit. Në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, **bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi** për pasuritë në **7 raste**, sipas referncave të sipërcituara(sipas pasqyrës bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**2-Gjetje:** ZVRPP Malësi e Madhe ka regjistruar leje ndërtimi rikonstruksion objekti, duke regjistruar në pronësi të subjektit E K pasurinë nr. 2/121-Nd<sub>3</sub>, ndërtesë me sipërfaqe 114 m<sup>2</sup> v. 3, faqe 29, lëshuar certifikatë pronësie me datë 16.10.2017, rezulton Leja e shfrytëzimit është marr me datë 13.04.2001 dhe regjistrimi është bërë me datë 16.10.2017, duke e regjistruar me vonesë në kundërshtim me nenin 38 dhe 39 të ligjit 33/2012 për mos regjistrimin në afat të aktit, për të cilin llogaritet detyrimi i penalitetit për vonesën në regjistrim, në vlerën **300,000 lekë për tu paguar nga subjekti**.

Sikurse evidentohet rezulton tjetërsimi i pasurisë “shtet” **objekti me sipërfaqe 114 m<sup>2</sup>, duke këluar** në pronësi të E K dhe shtuar sipërfaqja **për 20 m<sup>2</sup>** nga sipërfaqja ekzistuese, në **mungesë të dokumenteve që shërbejnë si Titull Pronësie**, e llogaritur sipas çmimit të vleresimit sipas kostos së Entit Banesave, rezulton e vlerësuar në shumën 114 m<sup>2</sup> x 40,500 = **4,617,000 lekë**, që përbën **dëm ekonomik dhe detyrim financiar, për tu arkëtuar nga subjekti**. Gjithashtu nuk rezulton të jenë percaktuar mardheniet e truallit me dhurim apo me shitje, ndërsa për përdorimin e truallit shtet, llogaritet qiraja për 50 lekë/ m<sup>2</sup>, që për tre vitet e fundit llogaritet detyrim për tu paguar në vlerën prej **188,100 lekë**[114 m<sup>2</sup>(sip. ndërtimi) x 50 lekë/m<sup>2</sup>(qeraja mujore/m<sup>2</sup>) x 33 muaj]. Në total i është **shkaktuar një dëm ekonomik shtetit në vlerën prej 5,105,000 lekë**.

Pasuria është regjistruar me leje ndërtimi për konstruksion në kundërshtim me dispozitat ligjore të përcaktuara nga ligjit të Urbanistikës nr. 8405, datë 17.09.1998, me ndryshime, në kundërshtim me ligjin nr. 10119, datë 23.04.2009 me ndryshime dhe udhëzimin nr. 3, datë 3.10.2012.

## **C. MASA DISIPLINORE**

Mbështetur në Kreu IV, neni 11 germa “d” dhe “e” dhe nenet 37, 141, dhe 153 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 8085, datë 13.03.1996, ligjin nr. 9125, datë 29.07.2003 dhe ligjin nr. 136/2015, Ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, si dhe në kontratën individuale të punës, **t’i kërkojmë Kryeregjistruesit ZQRPP Tiranë**, vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë për çdo punonjës të cituar më poshtë dhe marrjen e masave disiplinore nga **“Vërejtje me shkrim”** deri në **“Largim nga puna”**, për këta punonjës:

### C.1. “Vërejtje me paralajmërim”, për 1 punonjës, si më poshtë:

#### 1. G.K, me detyrë specialist hartograf,

-Për të metat e mangësitë e konstatuara, në zbatimin e procedurave në pranimin dhe administrimin e dokumentacionit tekniko ligjor dhe veprimeve të tjera të pasurive të paluajtshme, në mospërputhje me ligjin nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e zonave të ndërtimeve informale”, UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit”, Rregulloren nr. 184, datë 04.08.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar.

### C.1. - “Vërejtje me paralajmërim deri në Largim nga Puna (zgjidhje e kontratës)”, për 2 punonjës si më poshtë:

Për të meta e mangësi të konstatuara, në zbatimin e procedurave ligjore e nënligjore në pranimin dhe administrimin e dokumentacionit tekniko ligjor për regjistrim, sipas rastit për çdo punonjës:

#### 1. F.SH, me detyrë Regjistrues,

